



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 23.5.2023

Nr: 546

Ora: 15:00

VENDIM  
PËR

**SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË  
LIBOHOVË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenit 162 dhe nenit 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**VËREN:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, me vendimin nr. 65, datë 15.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Këshillin e Bashkisë Libohovë. Kundër vendimit të sipërcituar të KZAZ-së nuk rezulton të jetë bërë ankim brenda afateve ligjore.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe nenit 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Rezultati për subjektet zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Libohovë pasqyrohet në tabelën nr.1, në vijim:

(Tabela nr. 1)

Nr. FV	Subjekti Zgjedhor	Vota	Përqindja
1	Bashkë Fitojmë	697	26,85
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	1226	47,23
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	123	4,74
6	Partia Demokracia Sociale	114	4,39

Data 23.5.2023 Nr: 546  
Ora: 15:00



“Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Libohovë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

8	Partia Socialdemokrate	72	2,77
9	Partia Demokratike	288	11,09
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	76	2,93
	<b>Totali</b>	<b>2596</b>	100%

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 15 (pesëmbëdhjetë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Libohovë, në bazë të shkresës me nr. 198/1 Prot., datë 27.2.2023 të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Herësit e përfitur nga ky pjesëtim janë në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përfitur nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 15 (pesëmbëdhjetë). Nga kjo renditje marrim rezultatin e pasqyruar në tabelën nr. 3, në vijim:

(Tabela nr. 3)

Nr.	Herësi	Subjekti
1	1226	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	697	Bashkë Fitojmë
3	613	Partia Socialiste e Shqipërisë
4	408	Partia Socialiste e Shqipërisë
5	348	Bashkë Fitojmë
6	306	Partia Socialiste e Shqipërisë
7	288	Partia Demokratike
8	245	Partia Socialiste e Shqipërisë
9	232	Bashkë Fitojmë
10	204	Partia Socialiste e Shqipërisë
11	175	Partia Socialiste e Shqipërisë
12	174	Bashkë Fitojmë
13	153	Partia Socialiste e Shqipërisë
14	144	Partia Demokratike
15	139	Bashkë Fitojmë

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar në tabelën nr. 3.

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve të pasqyruar në tabelën nr. 4, në vijim.

(Tabela nr. 4)

<b>Subjekti Zgjedhor</b>	<b>Mandate</b>
Bashkë Fitojmë	5
Partia Socialiste e Shqipërisë	8
Partia Demokratike	2

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përllëgarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga KZAZ-ja.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenin 162 dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### **VENDOS:**

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Libohovë, si më poshtë:

<b>Subjekti Zgjedhor</b>	<b>Mandate</b>
Koalicioni “Bashkë Fitojmë”	5
Partia Socialiste e Shqipërisë	8
Partia Demokratike	2

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Libohovë, si më poshtë:

#### **Bashkë Fitojmë**

1.	Altin	Suat	Çomo
2.	Florica	Lliko	Suli
3.	Krenar	Asllan	Kulla
4.	Violeta	Lebib	Ruçi
5.	Roland	Selam	Kasma

### **Partia Socialiste e Shqipërisë**

1.	Asim	Hysni	Banushaj
2.	Behare	Beqo	Shehu
3.	Emin	Kadri	Beqari
4.	Arjana	Safet	Çomo
5.	Albjon	Artur	Bilibashi
6.	Elisabeta	Petrit	Kokoshi
7.	Kujtim	Bajo	Mushi
8.	Xhemile	Besim	Myslimi

### **Partia Demokratike**

1.	Reshat	Izmet	Tosuni
2.	Morena	Seit	Myslimi

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Bashkia Libohovë, herësit

Tabela nr. 2

NR_FV	SUBJEKTI	SIGLA	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
1	Bashkë Fitojmë	BF	697	348	232	174	139	116	99	87	77	69	63	58	H e r ë s i t
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	1226	613	408	306	245	204	175	153	136	122	111	102	
3	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	P.A.A	123	61	41	30	24	20	17	15	13	12	11	10	
6	Partia Demokracia Sociale	P.D.S	114	57	38	28	22	19	16	14	12	11	10	9	
8	Partia Socialdemokrate	PSD	72	36	24	18	14	12	10	9	8	7	6	6	
9	Partia Demokratike	PDSH	288	144	96	72	57	48	41	36	32	28	26	24	
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	P.D.I.U	76	38	25	19	15	12	10	9	8	7	6	6	